

Nr. Prot 635  
Dt 25/05/2011



*Z. Haxhinorri  
Z. Tolobeti  
te ndihpet*

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**Ministria e Punëve Publike dhe Transportit**  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E POLITIKAVE DHE PLANIFIKIMIT PER TRANSPORTIN  
Adresa: Sheshi Skënderbej nr. 5" Tel: ++355 4 2380 740; Fax: ++355 4 2227390

Nr. 2283/Prot.  
11

Tiranë, më 23/5 2011

**Z. ARBEN IMAMI**  
**MINISTËR I MBROJTJES**

Për Dijeni :

**Z. GAZMIR TAHIRI**  
**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE (DURRËS)**

**Z. ERVIN MAZNIKU**  
**DREJTOR EKZEKUTIV**  
**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**

**Z. PETRIT SULAJ**  
**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**  
**AGJENCIA NACIONALE E TRAFIKUT AJROR (ANTA)**

**LËNDA :** Përcillet Urdhri i Përbashkët i miratuar.

Zoti Ministër,


Bashëlidhur, ju përcjellim urdhërin e përbashkët të miratuar "Për dhënien e lejes së hyrjes në ujërat territoriale dhe fluturimeve në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë të anijeve dhe helikopterëve ushtarakë të Mbretërisë së Bashkuar në kuader të stërvitjes së përbashkët "Albanian Lion-2011".

Nga ana e strukturave përkatëse të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit do të merren të gjitha masat sipas legjislacionit në fuqi për zbatimin e këtij Urdhri dhe mbarëvajtjen e operimeve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**SOKOL OLLDASHI**

MINISTËR





## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE  
DHE TRANSPORTIT

Nr 829, datë 17/5 /2011

Nr 2283, datë 23/5 /2011

### URDHËR I PËRBASHKËT

#### PËR

#### **DHËNIEN E LEJES SË HYRJES NË UJËRAT TERRITORIALE DHE FLUTURIMEVE NË HAPËSIRËN AJRORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË ANIJEVE DHE HELIKOPTERËVE USHTARAKË TË MBRETËRISË SË BASHKUAR NË KUADËR TË STËRVITJES SË PËRBASHKËT "ALBANIAN LION-2011"**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 19 të ligjit Nr. 8671, datë 26.10.2000, "Për Pushtetet dhe Autoritetet e Komandimit dhe Drejtimit Strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të pikës 2 dhe 3, të nenit 19 të ligjit Nr. 9363, datë 24.03.2005, "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", i ndryshuar, pikës 6.1 Kreu II dhe pikës 11.1 Kreu III të VKM Nr. 357, datë 13.06.2007, "Për procedurat e lëshimit të lejeve (*Diplomatic Clearance*) për hyrjen, uljen e kalimin e mjeteve lundruese ushtarake, të mjeteve fluturuese ushtarake dhe mjeteve të transportit, dhe/ose të blinduara ushtarake të huaja, në hapësirën ajrore, detare dhe territoriale të RSH", si dhe Aktit Normativ Nr. 2, datë 29/04/2011 "Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët detare – amfibe "Albanian Lion – 2011",

#### URDHËROJMË :


1. Lejimin e hyrjes në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë të anijeve luftarake të Mbretërisë së Bashkuar "HMS ALBION", "HMS OCEAN", "HMS SUTHERLAND", "RFA CARDGIAN BAY", "RFA MOUNTS BAY", "RFA WAVE KNIGHT" dhe "RFA FORT ROSALIE" në kuadër stërvitjes së përbashkët "Albanian Lion – 2011".
2. Lejimin e hyrjes dhe kryerjen e fluturimeve në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë të helikopterëve Britanikë tip Apache, Sea King dhe Lynx në kuadër të stërvitjes "Albanian Lion - 2011".
3. Fluturimet të kryhen në lartësi të ulët ditën dhe natën larg qendrave të banuara në drejtimet Pashaliman – Sazan – Porto Palermo – Kuçovë.
4. Kjo leje është e vlefshme për periudhën 27 Maj deri në 04 Qershor 2011, sipas kërkesës bashkëlidhur këtij urdhri.

5. Komanda e Forcës Detare, Komanda e Forcës Ajrore dhe Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve, Autoriteti i Aviacionit Civil dhe Agjensia Nationale e Trafikut Ajror të koordinojnë punën, në bazë të akteve ligjore e n/ligjore në fuqi, për marrjen e masave.
6. Përgjigjet për zbatimin e këtij urdhri, Komanda e Forcës Detare, Komanda e Forcës Ajrore, Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve, Autoriteti i Aviacionit Civil dhe Agjensia Nationale e Trafikut Ajror.
7. Ndjek zbatimin e këtij urdhri, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të RSH në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Transporteve në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I MBROJTJES**


**ARBEN IMAMI**



The stamp is circular with the text 'REPUBLIKA E SHqipëRIE' at the top and 'MINISTRIA E MBROJTJES' at the bottom. In the center is the coat of arms of Albania. A handwritten signature in black ink is written over the stamp.

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE  
DHE TRANSPORTIT**

**SOKOL OLLDASHI**



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Sokol Olldashi', written over the printed name.

HMS ALBION	
Commanding Officer	Capt J D Morley
Length	176m
Beam	29.9m
Draught	7.8m
Displacement	19560 tonnes
Total Crew	294 (32 Officers)
Destination	Albanian Territorial Waters
Dates	27/5 to 04/06
2	HMS OCEAN
Commanding Officer	Capt A Betton
Length	208m
Beam	36m
Draught	6.7m
Displacement	22500t
Total Crew	740 (109 officers)
Destination	Albanian Territorial Waters
Dates	27/5 to 04/06
3	HMS Sutherland
Commanding Officer	Cdr R R Readwin
Length	133m
Beam	16.1m
Draught	7.3m
Displacement	4200t
Total Crew	181 (13 Officers)
Destination	TTW and DURRES (1-3 June)
Dates	27/5 to 04/06
4	RFA Cardigan Bay
Commanding Officer	Capt P B Minter
Length	176m
Beam	26.4m
Draught	5.8m
Displacement	16160t
Total Crew	60 (18 officers)
Destination	Albanian Territorial Waters
Dates	27/5 to 04/06
5	RFA Mounts Bay
Commanding Officer	Capt P Farmer
Length	176m
Beam	26.4m
Draught	5.8m
Displacement	16160t
Total Crew	60 (18 Officers)
Destination	Albanian Territorial Waters
Dates	27/5 to 04/06
6	RFA Wave Knight
Commanding Officer	Capt V B Ramsey-Smith
Length	196.5m
Beam	30.4m
Draught	10m
Displacement	31500t
Total Crew	80 (21 officers)
Destination	Albanian Territorial Waters
Dates	27/5 to 04/06
7	RFA Fort Rosalie
Commanding Officer	Capt R G Ferris
Length	183.9m
Beam	24.1m
Draught	8.6m
Displacement	36580t
Total Crew	195 (31 Officers)
Destination	Albanian Territorial Waters
Dates	27/5 to 04/06